



Pranuar / Dorezuar Punëhënë / Prodato Received / Delivered	29 - 03	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shitja e Protog. Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SAMSHOK	3121/2023		115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.332/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.332/2023 të datës 08.02.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rr."Pjetër Bogdani" P/14, Nr.61 e Epërme, në Komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 29.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.332/2023 e datës 08.02.2023 e parashtruar nga ankuesi.
- II. Anulohet konkursi i datës 22.11.2022 sipas numrit të referencës RN00010427 për pozitën Kryeinspektor Shëndetësor, i shpallur nga Ministria e Shëndetësisë si dhe shfuqizohen të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.
- III. Obligohet Udhëheqësi i Personelit të Ministrisë së Shëndetësisë, që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Shëndetësisë duke u bazuar në dispozitat e nenit 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 22.11.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me

datën 07.12.2022 ka shpallur konkursin Ngritje (avancim) në detyrë me numër të referencës RN00010427 lidhur me pozitën *Kryeinspektor i Shëndetësisë* në Ministrinë e Shëndetësisë-Departamentin e Inspektoratit Shëndetësor për klasën e pozitës Drejtues i Mesëm 1.

Ankuesi me datën 16.12.2022 ka aplikuar në konkursin e lartcekur, në të cilën procedurë rekrutimi ka qenë i përfshirë deri në fazën e verifikimit paraprak, meqë me datën 11.01.2023 Udhëheqesi i Njesisë së Burimeve Njerëzore ka nxjerrë Vendimin Nr.Prot.05-115 sipas të cilit ankuesit i është refuzuar aplikacioni, me arsyetimin se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit sipas nenit 39 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenit 53 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

I pakënaqur me vendimin mbi refuzimin e aplikacionit për pozitën e lartcekur, ankuesi me datën 17.01.2023 ka parashtruar ankesën me Nr.Prot.05-236 tek Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, për shkak të: interpretimit të gabuar të dispozitave ligjore, konstatimit të gjendjes së gabuar faktike, shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, aplikimit të gabuar të dispozitave procedurale, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, mohim i së drejtës së avancimit në karrierë i garantuar me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe legjislacionit përcjellës për të drejtën e punës.

Udhëheqesi i Divizionit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, me datën 23.01.2023 ka nxjerrë Vendimin Nr.Prot.05-236/2 sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit.

I pa kënaqur me vendimin lidhur me refuzimin e ankesës nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë, ankuesi me datën 08.02.2023, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1559/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të: interpretimit të gabuar të dispozitave ligjore, konstatimit të gjendjes së gabuar faktike, shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, aplikimit të gabuar të dispozitave procedurale, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, mohim i së drejtës së avancimit në karrierë i garantuar me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, mohim i së drejtës në avancim sipas paragrafit 1.2 të nenit 2 të Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi si dhe mohim i së drejtës në avancim sipas dispozitave të nenit 4 dhe dispozitave të ndërlidhura për avancim të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 15.02.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa me datën 28.02.2023, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga kjo e fundit së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 13.03.2023 me Vendimin me numër protokollit 2572/2023 ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.332/2023 të datës 08.02.2023, të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me Nr.Prot:1559/2023 të datës 08.02.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.Prot.05-236/2 të datës 23.01.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Ankesën e ankuesit Nr.Prot.05-236 të datës e parashtruar tek Njësia e Burimeve Njerëzore; Shkresa mbi rezultatet e verifikimit paraprak të datës 16.12.2022 e gjeneruar tek SIMBNJ; Vendimin Nr.Prot.05-4773 të datës 02.07.2021 nga Sekretari i Përgjithshëm i MSH-së; Konkursin me numër të referencës RN00006408 të datës 18.02.2021 nga Ministria e Shëndetësisë; Konkursin me numër të referencës RN00010427 të datës 22.11.2022 nga Ministria e Shëndetësisë; Vendimin Nr.Prot.05-115 të datës 11.01.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Shkresën zyrtare të datës 23.12.2022 përmes e-mailit zyrtar lidhur me komunikatën për media; Vendimin Nr.Prot.05-6844 të datës 22.12.2022 nga ushtruesi i detyrës së Ministrit të Shëndetësisë; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të ankuesit të datës 13.01.2017; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të ankuesit të datës 29.01.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 28.02.2023 nga Ministria e Shëndetësisë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Listën e aplikantëve e gjeneruar tek SIMBNJ; Aplikacionin e ankuesit të datës 16.12.2022 se bashku me dëshminë mbi fushën profesionale dhe përvojën e punës si dhe Vendimin VK/2023 të datës 13.03.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është e bazuar, sepse:

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se kriteret e konkursit për pozitën *Kryeinspektor shëndetësor* i shpallur nga Ministria e Shëndetësisë, sipas konkursit me numër të referencës RN00010427, kanë qenë si në vijim:

- *Kualifikime/trajnime të posaçme nga fusha përkatëse profesionale:*
- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve: Fakulteti i Mjekësisë, Stomatologjisë ose Farmacisë me të pakten 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku shtatë (5) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese.*

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së shpalljes së konkursit dhe zhvillimit të procedurave të rekrutimit për pozitën në fjalë, Kolegji i Këshillit fillimisht ka analizuar Aktgjykimin në rastin Nr.KO203/19 me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe ka gjetur se Gjykata Kushtetuese në pikën 211 të aktgjyimit ka konstatuar se: (...) *Deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për atë që nuk cenon funksionet dhe organizativitetin të Institucioneve të Pavarura të referuara specifikisht në dispozitiv të këtij Aktgjykimi. Ndërsa, në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi.* Andaj, si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit konstaton se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është i zbatueshëm nga data 09.07.2020, dhe i njëjti me dispozitat e nenit 32 paragrafit 3 ka përcaktuar, se: *Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet*

vetëm sipas këtij ligji, ndërsa neni 85 ka shfuqizuar Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Ministria e Shëndetësisë procedurën e rekrutimit lidhur me pozitën *Kryeinspektor shëndetësor*, e ka shpallur si Ngritje (avancim) në detyrë për klasën e pozitës Drejtues i Mesëm 1, me koeficient të pagës 10.

Inspektorati i Shëndetësisë në bazë të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, është i përfshirë në kategorinë e Agjencive, sipas shtojcës 1 e i listuar me numrin rendor 19, e i cili është Agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Po ashtu ky institucion trajtohet edhe në bazë të nenit 47 paragrafit 1 të Ligjit Nr.04/L-125 i plotësuar dhe ndryshuar sipas Ligjit Nr. 08/L-043 për Shëndetësi me të cilin përcaktohet se: *"1. Inspektorati shëndetësor është organ administrativ i Ministrisë. 2. Punët, organizimi, autorizimet, detyrat, dhe kompetencat e Inspektoratit Shëndetësor përcaktohen me ligj të veçantë"*.

Ndërsa pozita e *Kryeinspektorit shëndetësor* është përcaktuar në bazë të nenit 4 paragrafit 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit Nr.02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor i ndryshuar dhe plotësuar sipas Ligjit Nr.08/L-049 për Inspektoratin e Shëndetësisë, në të cilin përcaktohet se: *"4.1. Kryeinspektori është udhëheqës dhe përgjegjës për punën e Inspektoratit Shëndetësor. 4.2. Kryeinspektori siguron mbikëqyrjen e zbatimit unik të ligjeve dhe rregulloreve brenda kompetencave të Inspektoratit. 4.3. Kryeinspektori mbikëqyrë ekzekutimin e vendimeve që kanë të bëjnë me shkeljet ligjore. 4.4. Për punën e tij Kryeinspektori i përgjigjet Ministrisë të Shëndetësisë, e që rrjedhimisht në bazë të dispozitave të lartcekura Kolegji konstaton se pozita e *Kryeinspektorit Shëndetësor* është pozitë e lartë drejtuese në kuadër të Inspektoratit shëndetësor dhe si e tillë i përgjigjet direkt Ministrisë të Shëndetësisë.*

Ndërlidhur me shpalljen e pozitës në fjalë nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, Kolegji ka analizuar nenin 3 paragrafin 3.2 të Ligjit Nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor me të cilin përcaktohet se: *"3.2. Kryeinspektori për shëndetësi dhe inspektorët shëndetësorë zgjedhën përmes konkursit të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë në pajtim me rregullat e shërbimit civil"* dhe ndërlidhur me këtë rast ka konstatuar se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, konkretisht neni 85 i këtij ligji ka përcaktuar që: *"Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj"*, pasi që në kuptim të nenit 34 paragrafit 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përgjegjëse për shpalljen e konkursit respektivisht organizimin e konkurrimit për organet e administratës shtetërore është Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (DMZP) i cili funksionon në kuadër të ministrisë përgjegjëse për administratën publike, respektivisht Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe si rrjedhojë në rastin konkret janë shkelur parimet e pranimit të zyrtarëve publikë të përcaktuara me nenin 6 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Po ashtu, duke u bazuar në nenin 9 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 dhe nenin 22 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe nenin 2 paragrafin 3, dhe nenin 33 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit konstaton se pozita e *Kryeinspektorit shëndetësor* hynë në kategorinë e pozitave të nivelit të lartë drejtues në kuadër të Shërbimit Civil, dhe si e tillë i nënshtrohet regjimit juridik të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Rrjedhimisht,

me dispozitat e nenit 40, 41 dhe 42 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rregullohet procedura dhe mënyra e emërimit të nëpunësve civil në pozitat e kategorisë së lartë drejtuese. Andaj Kolegji me këtë rast konstaton se Ministria e Shëndetësisë me rastin e shpalljes së konkursit për pozitën *Kryeinspektor shëndetësor* si Ngritje (avancim) në detyrë për klasën e pozitës Drejtues i Mesëm 1, ka vepruar në kundërshtim me nenin 40 paragrafin 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë si dhe analizimit të dispozitave ligjore lidhur me kushtet dhe kriteret e pranimit në shërbimin civil, duke marrë për bazë edhe konstatimet e pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se konkursi i shpallur me datën 22.11.2022 sipas numrit të referencës RN00010427 për pozitën *Kryeinspektor Shëndetësor* i shpallur nga Ministria e Shëndetësisë, është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe se mbi këtë bazë edhe ka vendosur t'a anulojë të njëjtin si dhe të shfuqizojë çdo akt tjetër administrativ që rrjedh nga kjo procedurë e rekrutimit, kurse ankesa e ankuesit është aprovuar mbi bazën e kësaj të gjeture. Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar më tej në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, meqenëse shpallja e konkursit nuk ka qenë në harmoni me dispozitat akteve ligjore të përcaktuara si më lartë.

Nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji duke u bazuar në Nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton se një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedurë e paligjshme, kështu që me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.332/2023, datë 29.03.2023.

Ardita Derçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.